



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr.14, datë 20.06.2018

**PËR**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT  
“DENI”, NË PËRROIN E PËRPIZËS, NË KRAHUN E DJATHTË TË RRJEDHËS SË  
LUMIT MAT, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Asi-Tre” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Deni”, në përroin e Përpizës, në krahun e djathtë të rrjedhës së lumit Mat, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Asi-Tre” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor/kullosor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Bulqizë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDIRAMA**



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT



LEDIA TOTA